VENDIM
Nr. 242, datë 17.4.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 416, DATË 7.7.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NGA ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT QË OPEROJNË NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalia e parë, e pikës 2, të kreut I, të vendimit nr. 416, datë 7.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe përdoruesit që operojnë në parqet teknologjike dhe shkencore", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Përdoruesi, duke përfshirë NIPT-in primar dhe sekondar të tij, që të përfitojë lehtësirat fiskale, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama